



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.353/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NPG “MALSIJA”, me seli në Gurakoc-Istog, përfaqësuar sipas autorizimit nga R.G., kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit tutje (OSHP), me seli në Prishtinë. Adresa: Rr. “Migjeni”, ish ndërtesa e Bankës Lubjanës, Kati i V-të, për shkak të anulimit të Vendimit Nr. 811/19 i datës 15.01.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë publikë më datë 09.02.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit sipas R.G. dhe përfaqësuesit të palës së paditur sipas autorizimit A.D., më datë 08.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit NPG “MALSIJA”, me seli në Gurakoc-Istog kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me çka ka kërkuar të anulohet Vendimit Nr. 811/19 i datës 15.01.2020 i të paditurës OSHP dhe të urdhërohet e paditura që në afatin prej 15 ditësh t’ia paguaj paditësit shumën në emër të kompensimit të dëmit dhe fitimit të humbur si dhe shpenzimeve të tjerave, të cilat kanë ndodhur me rastrin e përgatitjes së këtyre dokumenteve, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur prej datë së paraqitjes së kërkesës së padisë deri në pagesën definitive të obligimit si dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia paguaj të gjitha shpenzimet procedurale të kësaj procedure dhe të asaj gjate ankesave, **si e pa bazuar**.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 14.02.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative paditësi NPG “MALSIJA”, me seli në Gurakoc-Istog, ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.nr. 345/2020, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit Vendimit Nr. 811/19 i datës 15.01.2020, i të paditurës OSHP, me propozim që të aprohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadi e paditësit dhe të anulohet vendimi Nr. 811/19 i datës 15.01.2020, i të paditurës OSHP, të urdhërohet e paditura që në afatin prej 15 ditësh t’ia paguaj paditësit shumën e cila do të konstatohet nga trajtimi i provave me anë të ekspertizës financiare, në emër të kompensimit të dëmit dhe fitimit të humbur si dhe shpenzimeve të tjerave, të cilat kanë ndodhur me rastrin e përgatitjes së këtyre dokumenteve, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur prej datë së paraqitjes së kërkesës së padisë deri në pagesën definitive të obligimit si dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia paguaj të gjitha shpenzimet procedurale të kësaj procedure dhe të asaj gjate ankesave.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 353/22.
3. Me datë 09.02.2024 gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit R.G., sipas autorizimit të datës 09.02.2024 dhe përfaqësuesit të palës së paditur A.D., sipas autorizimit të datës 25.01.2024.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesorë si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, Autoriteti Kontraktues (AK), Komuna e Vushtrrisë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal”, me numër të prokurimit 64418-8683-121 e ka publikuar Njoftimin për kontratë në ëeb faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik KRPP-së, nga AK Komuna e Vushtrrisë, më datë 09.11.2018. Pas hapjes së ofertave nga AK

Komuna e Vushtrisë kryen vlerësimin e ofertave duke propozuar që me kontratë publike të shpërblehet grupi i OE NPG “MALËSIA”, në vlerë të përgjithshme prej 66,248.56 euro, ndërsa më datë 25.10.2019 AK ka njoftuar përmes Njoftim mbi vendimin e AK se me kontratë publike propozohet që të shpërblehet oferta e grupit të OE “ER-LIS” SH.P.K., &NNT “Eing Com”, me seli në Pejë pas procedurës së shqyrtimit të ankesës së OE “ER-LIS” SH.P.K., &NNT “Eing Com”, ka anuluar Njoftimin e AK duke e obliguar AK që të analizoj edhe njëherë korrigjimet e çmimeve në ofertën e tyre financiare, me theks të veçantë gabime e bëra në kalkulimin e TVSH-së. OSHP mbi bazën e konstatimeve të ekspertës shqyrtuese në vendimin e tij Nr. 299/19 i datës 17.07.2019 dhe Nr. 46/19 08.10.2019, ka gjetur se dallimi i gabimeve aritmetike në ofertën e tuaj i tejkalon normën elejuar+2%, duke u bazuar në nenin 59 par. 3 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës ku sipas ekspertës së prokurimit e cila nga kalkulimi i vetëm 4 pozicione si Njësia, Sasia çmim për njësi (pa tvsh) çmimi total me TVSH i llogaritur nga ekspertja e prokurimit Çmimi total me TVSH i lejuar nga ju. Totali i përgjithshëm çmimi me TVSH 21,743.01 euro, çmimi pa TVSH 18,116.00 euro diferenca 3,627.01, ndërsa norma e lejuar e gabimeve aritmetike për katër pozicione , sipas normës 2%, të lejuar është 362.32 euro. Andaj, mbi bazën e të gjeturave të OSHP-së dhe ekspertës shqyrtuese të artikuluar në vendimet e saj nr. 299/19 i datës 17.07.2019 dhe Nr. 465/19 i datës 08.10.2019 është konstatuar se tenderi respektivisht oferta ka gabime aritmetike mbi 2 %, gjë që është në kundërshtim me nenin 59 par. 3 i Ligjit Nr. 04/K-04 për Prokurimin Publik të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, citat “ Autoriteti Kontraktues do të përmirësoj gabimet në një tender të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve, sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se 2 % të vlerës totale të ofertës.”

5. Ka deklaruar se, pas ankesës së parashtruar nga OE NPG “Malësija” tani paditës, AK Komuna e Vushtrisë nxjerr konkluzion për pezullim të përkohshëm të aktivitetit të prokurimit. Eksperti shqyrtues i OSHP-së harton një raport të ekspertizës, me të cilin raport OE NPG “Malësija”, nuk pajtohet dhe në afatin e paraparë e njofton OSHP. OSHP më datë 15.01.2020 me vendim Nr. 811/19 , ndërsa me rastin e trajtimit të ankesë së OE NPG “Malësija”, në panelin shqyrtues të OSHP-së përfaqësuesi i

kompanisë NPG “Malësija”, nuk ftohet fare që të merr pjesë në seancën e shqyrtimit kryesorë. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadi e paditësit dhe të anulohet vendimi Nr. 811/19 i datës 14.01.2020, i të paditurës OSHP, të urdhërohet e paditura që në afatin prej 15 ditësh t’ia paguaj paditësit shumën e cila do të konstatohet nga trajtimi i provave me anë të ekspertizës financiare, në emër të kompensimit të dëmit dhe fitimit të humbur si dhe shpenzimeve të tjerave, të cilat kanë ndodhur me rastrin e përgatitjes së këtyre dokumenteve, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur prej datë së paraqitjes së kërkesës së padisë deri në pagesën definitive të obligimit si dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia paguaj të gjitha shpenzimet procedurale të kësaj procedure dhe të asaj gjate ankesave.

Kundërshtimet e të paditurës

6. Përfaqësuesi i të paditurës, në përgjigje në padi sipas parashtrësës së datës 16.01.2024, gjatë deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesorë publik si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk qëndron fakti se paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional lidhur me pretendimin e OE ankues NPG “Malësia”, se OSHP nuk ka respektuar neni 1 të LLPP-së, sepse OE ankues i eliminuar nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me njoftimim për kontratë dhe në dosjen e tenderit AK gjatë rivlerësimit, OE ankues, e ka trajtuar si OE të eliminuar ngase ishte me ofertë me gabime në kalkulim mbi normën e lejuar +2%, duke sqaruar se kjo ishte vërtetuar edhe nga paneli shqyrtues me vendimin PSH.nr. 465/19 të datës 08.10.2019, andaj nuk i plotëson kriteret e parapara me Njoftimim për kontratë dhe dosjen e tenderit. Sa i përket pretendimit të OE se nuk është respektuar neni 39 i Rregullave e Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik (RrUOPP) sipas OE ankues dhe neni 59 i LPP-së, nenin 41 të RRUOPP-së, paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues ka deklaruar se fillimisht AK ka themeluar komision të Ri-vlerësimit i cili OE ankues e ka trajtuar si OE të eliminuar dhe ky trajtim është në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe nenin 42 të RrUOPP-së. Neni 39.2 i RrUOPP-së citon se “Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt i tenderit nuk mund të kërkohej, ofrohet apo lejohet”.

7. Ka shtuar se paneli shqyrtues ka sqaruar se nëse analizohet siç e ka dorëzuar ofertën OE ankues, shihet qartë se është ndryshuar e tërë oferta te çmimi për TVSH, në kundërshtim me nenin 39.2. OE ankues nëse e ka përdorur përshkrimin e çmimit të krijuar nga AK përmes platformës së e-prokurimit, te çmimi për njësi me TVSH e ka dhënë çmimin që përputhet me totalin e çmimit të ofertës, mirëpo i njëjti gabimisht të norma e tvsh-së nuk ju kishte përmbajtur udhëzimit dhe gabimisht e ka shkruar vlerën e tvsh-së, jo sikurse ishte udhëzuar ta paraqet vetëm me 0.8 ose 18, andaj tabela formula e ndryshon edhe çmimin për njësi dhe me këtë veprim ndryshohet tërë oferta, sepse ndryshohet çmimi për njësi pa TVSH dhe bazuar në këtë çmim ndryshon e tërë oferta dhe bie ndesh me pikën B të nenit 41 të RrUOPP-së ku ekskluzivisht përcakton se “Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë gabim çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr. Por edhe në rast se OE ankues ka të përdorur tabelën e vet të krijuar në Excel, prapë se prap ka vepruar gabimisht sepse dallimi i gabimit aritmetik, e tejkalon normën e lejuar +2%, duke u bazuar në nenin 59 par 3 i LPP-së. Paneli shqyrtues ka sqaruar se eksperti shqyrtues i prokurimit ka kalkuluar vetëm 4 pozicione si me ekspertizë paraprake dhe ka analizuar edhe pretendimet e OE ankues në tabelën e dorëzuar me ankesë, duke ardhur në përfundim se OE ankues gabimisht e ka ndryshuar tabelën-përshkrimin e çmimit ku e ka ndryshuar komplet çmimin për njësi duke dhënë vlera për njësi që i përshtaten totalit të çmimit që kjo nënkupton ndryshim të ofertës. Totali i ofertës i dhënë nga OE me rastin e dorëzimit të ofertës 62,484.52 euro totali i çmimit me TVSH 66,248.56 euro. Totali i ofertës i korrigjuar nga OE 56,321.32 euro, totali i TVSH 9,927.24 euro, totali i çmimit me TVSH 66,248.56 euro. Dallimi në kalkulim të totalit të çmimit pa tvsh është më tepër se +2%. $62,484.52 - 56,321.32 = 6,341.67$ euro, gabim në kalkulim sipas ofertës së dorëzuar nga OE ankues dhe ofertës së korrigjuar me ankesë nga vet OE ankues 6,341.67 euro kurse norma e lejuar e gabimit aritmetik sipas formulës $56,142.85 * 2\%$ është 1,122.85 euro, duke e tejkuluar normën e lejuar në gabimet në kalkulim, që norma e lejuar për gabime gramatikore është deri 1,122.85 euro, kurse vet OE ankues ka konstatuar se ka gabime të totalit pa TVSH, gabimi është në vlerë prej 6,341.67 euro. Mbi këtë bazë është vërtetuar se ka gabime në kalkulim mbi normën e lejuar, andaj konstatojnë se AK me rastin e rivlerësimit ka nxjerr vendim konform LPP-së dhe RrUOPP-së, ngase Paneli shqyrtues konstaton se dallimi i gabimit aritmetik të ofertës së OE ankues e

tejkalon normën e lejuar $\pm 2\%$, andaj bazuar në nenin 59 par.3 të LPP-së dhe ekspertja e prokurimit ka kalkuluar vetëm 4 pozicione dhe është vërtetuar se ka gabime në kalkulim mbi normën e lejuar. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional, konstaton se është i paqëndrueshëm pretendimi i ankuesit ku ai pretendon se ka gabime vetëm në TVSH dhe për të njëjtat nuk vlen rregulla $\pm 2\%$, për faktin se sikur të ishte gabimi vetëm në TVSH do të ishte në rregull të njëjta nuk do të kishin paraqitur problem sepse është e qartë dhe për të njëjtin çështje jo vetëm se ka jep interpretim KRPP, por ajo çështje është e gjykuar sepse ka vendim në OSHP që gabimet në TVSH i ka trajtuar si gabime që nuk hyjnë tek rregulli $\pm 2\%$, mirëpo rasti i OE ankues hyn te gabimet në kalkulim sepse e tejkalojnë normën e lejuar. OE ankues ka vepruar në këtë mënyrë duke i ndryshuar çmimet për njësi Pozicioni 1 çmimi për njësi në vend të çmimit 1.79, është ndryshuar në cmim 1.53, Pozicioni 2 çmimi për njësi në vend të çmimit 0.90 është ndryshuar në cmim 0.76, Pozicioni 3 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89, është ndryshuar në cmim 6.78, Pozicioni 4 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89 është ndryshuar në cmim 6.78, në kundërshtim me nenin 41.9 të RrUOPP-së që përcakton se çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet dhe se në rastin kur tenderuesi pretendon se ka bërë gabim në cmim për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr, dhe kjo dispozitë nuk ka ndarje që do të lejonte korrigjimin e çmimeve për njësi pa TVSh siç ka vepruar OE ankues në tërë ofertën. Lidhur me pretendimin e OE NPG “Malsija”, se AK nuk ka respektuar nenin 72 të LPP-së, paneli shqyrtues duke e pasur parasysh faktin se kjo pikë nuk ishte e përfshirë në kërkesën për rishqyrtim, nuk është shqyrtuar sepse PSH është e bazuar vetëm në pretendimet ankimor e që kanë qenë të njëjta si tek kërkesa për rishqyrtim ashtu edhe tek ankesa në OSHP, kjo bazuar në nenin 9.2 të RrUOPP. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si e pa bazuar padia e paditësit NPG “Malsija” SH.P.K., dhe të vërtetohet si i ligjshëm Vendimi PSH.nr. 811/19 i datës 14.01.2020.

Provat e administruara

8. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm të datës

07.03.2019 për NPG Malësia, Letër standarde të kërkesës për zgjatjen e validitetit të tenderit, Kërkesë nga AK-Komuna Vushtrri për dëshmi shtesë nga NPG Malësia me datë 20.05.2019, Njoftim mbi vendimin e AK me date 30.05.2019, Njoftim mbi vendimin e AK me date 25.10.2019, Vendim i PSH të OSHP-së me nr.299/19 I datës 04.07.2019, Vendim i PSH të OSHP-së me nr. PSH 465/19 të datës 23.09.2019, Konkluzion për pezullim të përkohshëm të AP me datë 11.06.2019, Konkluzion për pezullim të përkohshëm të AP me datë 01.08.2019, Konkluzion për pezullim të përkohshëm të AP me datë 05.11.2019, Konkluzion për pezullim të përkohshëm të AP me datë 18.11.2019, Vendim i AK-Komuna Vushtrri mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me datë 07.11.2019, Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm me datë 28.10.2019 për OE ER-LISI ShPK dhe NNT Eing Com-Pejë, Raporti i ekspertit shqyrtues Teuta Krasniqi me datë 26.12.2019, Kërkesë për rishqyrtim nga OE NPG Malësia me datë 04.11.2019 për AK-Komuna Vushtrri, Shkresë me datë 24.01.2020, Vendim i kundërshtuar me nr.PSH.811/19 i datës 15.01.2020, Gjykatës i'a dorëzon edhe një format të përshkrimit të çmimeve, pjesë e dosjes së tenderit, e njëjta administrohet si provë

9. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklarimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar. Nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:
10. Me Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm të datës 07.03.2019 për NPG Malësia, AK Komuna e Vushtrrisë, ka njoftuar NPG “MALSIJA”, se tenderi i tyre i paraqitur nuk ishte i suksesshëm sepse nuk ka qenë tenderi me çmim më të ulët.
11. Me Letër standarde të kërkesës për zgjatjen e validitetit të tenderit, AK Komuna e Vushtrrisë, ka njoftuar NPG “MALSIJA”, se me vendim të Organit Shqyrtues të prokurimit nr. 126/19 i datës 02.05.2019 sipas ankesës së OE “Er-Lis” SH.P.K. &NNT “Eing Com” lënda është kthyer në rivlerësim, andaj i ka kërkuar NPG “MALSIJA”, që të vazhdojnë vlefshmëria e tenderit. AK me datës 20.05.2019, ka në

pajtim me nenin 9 të rregullores për prokurimin publik i ka kërkuar “Malësija” sh.p.k që të sigurojnë prova-dëshmi dokumentuese në lidhje me përmbushjen e kërkesave mbi pranueshmërinë-përshtatshmërinë e tyre. Me date 30.05.2019 AK Komuna e Vushtrrisë e ka njoftuar se e ka shpërblyer me kontratë NPG “Malsija” me seli ën Klinë, në vlerë totale të ofertës në shumë prej 66,248,56 euro. Ndaj këtij njoftimi ka parashtruar ankesën e OE “Er-Lis” SH.P.K., &NNT “EingCom” Pejë.

12. OSHP-së me Vendim nr.299/19 të datës 04.07.2019, ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE “Er-Lis” SH.P.K., &NNT “EingCom” Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal”, me nr. të prokurimit. 644-18-8683-1-2-1, i iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Vushtrri, dhe e ka anuluar njoftimin për dhënie të kontratës, me arsyetim se lidhur me pretendimin e OE ankues se AK e ka trajtuar OE “Malsija” si OE të përgjegjshëm ndërsa i njëjti është i pa përgjegjshëm. paneli shqyrtues sqaron ekspertja shqyrtues ka konstatuar se dallimi i gabimit aritmetik e tejkalon normën e lejuar +-2%, duke u bazuar në nenin 59 par. 3 të LPP-së se ekspertja shqyrtuese profesionale ka kalkuluar vetëm 4 pozicione dhe është e vërtetuar se ka gabime në kalkulim mbi normën e lejuar, andaj konstaton se AK me rastin e rivlerësimit gabimisht ka kalkuluar çmimet e OE “Malësia” sh.p.k. ashtu që Komisioni i vlerësimit të AK i ka ndryshuar çmimet për njësi duke i’ a përshtatur totalit të ofertës së AK-së dhe gabimisht pretendon se ka gabime vetëm në TVSH dhe për të njëjtat nuk vlen rregulla +-2%, sepse gabimet në kalkulim e tejkalojnë normën e lejuar, dhe AK nuk ke të drejtë ti ndryshoni çmimet për njësi. Pozicioni 1 çmimi për njësi në vend të çmimit 1.79, është ndryshuar në cmim 1.53, Pozicioni 2 çmimi për njësi në vend të çmimit 0.90 është ndryshuar në cmim 0.76, Pozicioni 3 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89, është ndryshuar në cmim 6.78, Pozicioni 4 çmimi për njësi në vend të çmimi 7.89 është ndryshuar në cmim 6.78, në kundërshtim me nenin 41.10 pika b dhe 41 të RrUOPP-së që përcakton se çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet dhe se në rastin kur tenderuesi pretendon se ka bërë gabim në cmim për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr, dhe kjo dispozitë nuk ka ndarje që do të lejonte korrigjimin e çmimeve për njësi pa TVSh siç ka vepruar OE ankues në tërë ofertën.

13. Me datë 01.08.2019 AK Komuna e Vushtrisë, përmes konkluzionit ka pezulluar përkohësisht aktivitetin e prokurimit lidhur me projektin “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal” prok. Nr. 644-18-227-121 për shkak se në OSHP është dorëzuar ankesë nga OE, kundër vendimit të AK. Nga Vendim i PSH të OSHP-së me nr. PSH 465/19 të datës 23.09.2019, Paneli Shqyrtues e ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE “Er-Lis” SH.P.K., &Eing SH.P.K.” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Sinjalizimi horizontal dhe vertikal”, me nr. të prokurimit. 644-18-8683-1-2-1, i iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Vushtrri, dhe e ka anuluar njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Sinjalizimi horizontal dhe vertikal”, me nr. të prokurimit. 644-18-8683-1-2-1, i iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Vushtrri.
14. Me date 25.10.2019, AK Komuna e Vushtrisë ka shpërblyer me kontratë “ER-LIS” SH.P.K., &NNT “Eing Com”, me seli në Pejë, në vlerë totale të ofertës në shumë prej 69,974.90 euro.
15. Me datë 05.11.2019, AK Komuna e Vushtrisë, përmes konkluzionit ka pezulluar përkohësisht zbatimin e aktivitetit të prokurimit lidhur me projektin “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal” prok. Nr. 644-18-227-121 për shkak se AK ka pranuar kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-së.
16. AK-Komuna Vushtrri me vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me datë 07.11.2019, e ka refuzuar si e pa bazë kërkesa për rishqyrtim lidhur me njoftimin letë për Tenderuesin e Eliminuar të subjektit në procedurë NPTGH “Malsija”, dhe është vërtetuar njoftimi për dhënie të kontratës në bazë të njoftimit mbi vendimin e AK të datës 25.10.2019.
17. Me datë 18.11.2019 AK Komuna e Vushtrisë, përmes konkluzionit ka pezulluar përkohësisht zbatimin e aktivitetit të prokurimit lidhur me projektin “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal” prokurimit Nr. 644-18-227-121 për shkak se në OSHP është dorëzuar ankesë kundër vendimit të AK.
18. Raporti i ekspertit shqyrtues Teuta Krasniqi me datë 26.12.2019, eksperti shqyrtues kishte konstatuar se dallimi i gabimit aritmetik e tejkalon normën e lejuar +-2%, kurse

OE ankues gabimisht pretendon se ka gabime vetëm në TVSH, për të njëjta nuk vlen rregulla +-2%, sikur të ishte gabimi vetëm në tvsh, do të ishte në rregull sepse sipas interpretimit të KRPP, por eshë vendimeve në OSHP gabimet në TVSH nuk hyjnë tek rregulli +-2%, kështu që rasti i OE ankues hyn te gabimet në kalkulim sepse e tejkalojnë normën e lejuar. OE ankues ka vepruar në këtë mënyrë duke i ndryshuar çmimet për njësi Pozicioni 1 çmimi për njësi në vend të çmimit 1.79, është ndryshuar në cmim 1.53, Pozicioni 2 çmimi për njësi në vend të çmimit 0.90 është ndryshuar në cmim 0.76, Pozicioni 3 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89, është ndryshuar në cmim 6.78, Pozicioni 4 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89 është ndryshuar në cmim 6.78, në kundërshtim me nenin 41.9 të RrUOPP-së që përcakton se çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet dhe se në rastin kur tenderuesi pretendon se ka bërë gabim në çmim për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr, dhe kjo dispozitë nuk ka ndarje që do të lejonte korrigjimin e çmimeve për njësi pa TVSh siç ka vepruar OE ankues në tërë ofertën.

19. Nga Kërkesë për rishqyrtim nga OE NPG Malësia me datë 04.11.2019 për AK-Komuna Vushtrri, N.P.G. “Malsija”, në cilësinë e palës së interesuar nga rezultati i aktivitetit të prokurimit, kundër njoftimit mbi vendimin e AK për dhënie të kontratës publike më datë 28.10.2019, ka bërë kërkesë për rishqyrtim të tenderit.
20. Nga Shkresë me datë 24.01.2020, OE , N.P.G. “Malsija” i është drejtuar panelit shqyrtues të organit shqyrtues të prokurimit që edhe një herë të shqyrtojnë aktivitetin e prokurimit sa i përket mënyrës së llogaritjes së % së TVSH-së për produktet e caktuara të cilat janë lëndë e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse është vlerësuar gabimisht nga ekspertja e shqyrtimit.
21. Nga Vendim i kundërshtuar me nr.PSH.811/19 i datës 15.01.2020, paneli shqyrtues i OSHP-së e ka aprovuar si pjesërisht ankesën e OR “ Malsija”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal”, me nr të prokurimit. 644-18-8683-1-2-1, i inicuar nga AK Kuvendi Komunal Vushtrri dhe ka vërtetuar njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal”, me nr. të prokurimit. 644-18-8683-1-2-1, i inicuar nga AK Kuvendi Komunal Vushtrri, me arsyetim se paneli shqyrtues

konform ekspertit shqyrtues profesional lidhur me pretendimin e OE ankues NPG “Malësia”, se OSHP nuk ka respektuar neni 1 të LLPP-së, nuk qëndron për faktin se trajtimi i OE ankues si OE i eliminuar nuk ka plotësuar kriteret e parapara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Sa i përket pretendimit të OE se nuk është respektuar neni 39 i Rregullave e Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik (RrUOPP) sipas OE ankues dhe neni 59 i LPP-së, nenin 41 të RRUOPP-së, paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues ka deklaruar neni 39.2 i RrUOPP-së citon se “Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt i tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet apo lejohet. Paneli shqyrtues ka konstatuar se është ndryshuar e tërë oferta te çmimi për TVSH, në kundërshtim me nenin 39.2. Nenit 41 të RrUOPP-së ekskluzivisht përcakton se “Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet. Totali i ofertës i dhënë nga OE me rastin e dorëzimit të ofertës 62,484.52 euro totali i çmimit me TVSH 66,248.56 euro. Totali i ofertës i korrigjuar nga OE 56,321.32 euro, totali i TVSH 9,927.24 euro, totali i çmimit me TVSh 66,248.56 euro. Dallimi në kalkulim te totali i çmimit pa tvsh është më tepër se +2%. $62,484.52 - 56,321.32 = 6,341.67$ euro, gabim në kalkulim sipas ofertës së dorëzuar nga OE ankues dhe ofertës së korrigjuar me ankesë nga vet OE ankues 6,341.67 euro kurse norma e lejuar e gabimit aritmetik sipas formulës $56,142.85 * 2\%$ është 1,122.85 euro, duke e tejkalar normën e lejuar në gabimet në kalkulim, që norma e lejuar për gabime aritmetike është deri 1,122.85 euro, kurse vet OE ankues ka konstatuar se ka gabime te totali pa TVSH, gabimi është në vlerë prej 6,341.67 euro. Mbi këtë bazë ka vërtetuar se ka gabime në kalkulim mbi normën e lejuar, andaj ka konstatuar se AK me rastin e rivlerësimit ka nxjerr vendim konform LPP-së dhe RrUOPP-së.

Baza Ligjore

22. LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS neni 7 përcakton , Barazinë në Trajtim/ Jo-Diskriminim, paragrafi 1 specifikon se: “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente” Neni 59 përcakton Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve, paragrafi 1 përcakton se “Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, paragrafi 2 përcakton “Autoriteti kontraktues

mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues”, paragrafi 3 përcakton “Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve. Autoriteti kontraktues menjëherë do t’i dërgojë të gjithë tenderueseve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla”, paragrafi 4 “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”,

23. Neni 60 përcakton Kriteret për Dhënien e Kontratës, paragrafi 1 përcakton se “Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar”, 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji”. Neni 117 përcakton se “Afati i fundit për marrjen e vendimeve 1. OSHP do të nxjerrë vendimin e tij përfundimtar me shkrim, së bashku me një deklaratë me shkrim mbi arsyet faktike dhe ligjore mbi të cilat është marrë një vendim i tillë, dhe ndonjë urdhër që nevojitet për zbatimin e vendimit të tillë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas skadimit të afatit kohor të specifikuar në paragrafin 7. të nenit 115 të këtij ligji, apo pas dorëzimit të informative shtesë dhe/apo shpjegimeve apo dëgjimeve sipas nenit paragrafin 3. apo 4. të nenit 116 të këtij ligji. Kur në çështje janë të përfshira fakte veçanërisht të ndërlikuar, OSHP mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të

shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë për nxjerrjen vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrit të tij” .

RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK, neni 39 pika 2 përcakton se *“Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet”.*, Neni 41.10 përcakton se *“Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për tenderuesin; a. Në rast se tenderuesi nuk i pranon ato, tenderi i tij do të refuzohet; b. Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigojëhet. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet si i tërhequr”.*

Vlerësimi i gjykatës

24. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësi, kundërshtimeve sipas përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.
25. Gjykata vlerëson se me vendimi i kundërshtuar e paditura e ka aprovuar si pjesërisht ankesën e OE “Malsija”, tani si palë paditëse lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal”, me nr. të prokurimit. 644-18-8683-1-2-1, i iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Vushtrri, dhe ka vërtetuar njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal”, me nr. të prokurimit. 644-18-8683-1-2-1, i iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Vushtrri, me arsyetim se AK gjatë rivlerësimit e ka trajtuar OE ankues si OE të eliminuar ngase ishte me ofertë me gabime në kalkulim mbi normën e lejuar +2%, duke sqaruar se kjo ishte vërtetuar edhe nga paneli shqyrtues përkatësisht me vendimin PSH.nr. 465/19 të datës 08.10.2019, andaj nuk i plotëson kriteret e paraparë me Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Gjykata vlerëson se në përputhje me nenin 39.2 i RrUOPP-së “Asnjë ndryshim në cmim ose kusht tjetër material ose aspekt i tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet apo lejohet”. OE “Malësija” sh.p.k

ka ndryshuar ofertën të çmimi për tvsh, në kundërshtim me nenin 39.2, i njëjti gabimisht të norma e tvsh-së nuk ju kishte përmbajtur udhëzimit ta paraqet vetëm me 0.8 ose 18 e ka shkruar vlerën e tvsh-së, andaj me këtë veprim ka ndryshuar e tërë oferta, në kundërshtim me pikën b të nenit 41 të RrUOPP-së ku përcakton se “Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë gabim çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr”, prandaj dallimi i gabimit aritmetik, e ka tejkaluar normën e lejuar +2%, duke u bazuar në nenin 59 par 3 i LPP-së. Prandaj në tabelën-përshkrimin e çmimit ku ka ndryshuar komplet çmimin për njësi dukë dhënë vlera për njësi që i përshtaten totalit të çmimit kjo ka rezultuar në ndryshim të ofertës. Totali i ofertës i dhënë nga OE me rastin e dorëzimit të ofertës 62,484.52 euro totali i çmimit me TVSH 66,248.56 euro. Totali i ofertës i korrigjuar nga OE 56,321.32 euro, totali i TVSH 9,927.24 euro, totali i çmimit me TVSh 66,248.56 euro. Dallimi në kalkulim të totalit të çmimit pa tvsh është më tepër se +2%. $62,484.52 - 56,321.32 = 6,341.67$ euro, gabim në kalkulim sipas ofertës së dorëzuar nga OE ankues dhe ofertës së korrigjuar me ankesë nga vet OE ankues 6,341.67 euro, kurse norma e lejuar e gabimit aritmetik sipas formulës $56,142.85 * 2\%$ është 1,122.85 euro, duke e tejkaluar normën e lejuar në gabimet në kalkulim, që norma e lejuar për gabime gramatikore është deri 1,122.85 euro. Gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit se ka gabime vetëm në TVSH dhe për të njëjtat nuk vlen rregulla +-2%, dhe është në përputhje me interpretim KRPP që gabimet në TVSH i ka trajtuar si gabime që nuk hyjnë tek rregulli +-2%. Gjykata konstaton se me nenin 59 paragrafi 3 përcakton se “*Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve. Autoriteti kontraktues menjëherë do t’i dërgojë të gjithë tenderuesëve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla*” mirëpo, OE ankues i ndryshuar çmimet për njësi Pozicioni 1 çmimi për njësi në vend të çmimit 1.79, është ndryshuar në çmim 1.53, Pozicioni 2 çmimi për njësi në vend të çmimit 0.90 është ndryshuar në çmim 0.76, Pozicioni 3 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89, është ndryshuar në çmim 6.78, Pozicioni 4 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89 është ndryshuar në çmim 6.78, në kundërshtim me nenin 41.9 të RrUOPP-së që përcakton se çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet dhe se në rastin kur tenderuesi pretendon se ka bërë gabim në çmim për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr.

26. Prandaj nga provat e administruara gjykata vlerësoj se e paditura drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike në procedurë administrative kur e ka aprovuar si pjesërisht ankesën e OE “Malsija”, tani si palë paditëse, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal”, me nr. të prokurimit. 644-18-8683-1-2-1, i iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Vushtrri dhe ka vërtetuar njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal”, me nr. të prokurimit. 644-18-8683-1-2-1, i iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Vushtrri ngase në rastin konkret Gjkata vlerëson se dallimi është në kalkulim te totali i çmimit pa tvsh është më tepër se +2%. $62,484.52 - 56,321.32 = 6,341.67$ euro, gabim në kalkulim sipas ofertës së dorëzuar nga OE ankues dhe ofertës së korrigjuar me ankesë nga vet OE ankues 6,341.67 euro kurse norma e lejuar e gabimit aritmetik sipas formulës $56,142.85 * 2\%$ është 1,122.85 euro, duke e tejkualuar normën e lejuar në gabimet në kalkulim deri 1,122.85 euro, e që tejkalon normën +-2%, në kundërshtim me nenin 41.10 pika b të RrUOPP-së.
27. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.353/22, datë 08.03.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimin të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.